

VENDIM
Nr. 851, datë 29.12.2021

**PËR MIRATIMIN E TRANSFERTËS KAPITALE NË LLOGARI TË FONDIT
SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009 “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 102/2020 “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi prej 400 000 000 (katërqind milionë) lekësh, i parashikuar për ndërhyrjen dhe përmirësimin e konektivitetit dhe rrugëve të aksesit, në kuadër të programit buxhetor të 100 fshatrave, kalohet nga zëri “Investime” (231) në zërin “Transferte kapitale” (232), për llogari të Fondit Shqiptar të Zhvillimit (SHZH), për blerje makinerish, si pjesëmarrje në kapitalin e operatorit për mirëmbajtjen dhe hapjen e rrugëve rurale dhe turistike, në bashkëpunim me njësitë vendore.

2. Fondi prej 600 000 000 (gjashtëqind milionë) lekësh, i parashikuar në “Programe zhvillimi”, përkatësisht 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë, kapitulli 04 zëri “TVSH”, dhe 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, kapitulli 03 “Financimi i kostos së bashkëfinancimit të projekteve, që zbatohen nga FSHZH”, kalon si transferte kapitale (232) për llogari të FSHZH-së për zhvillimin e modelit të integruar në formën e një parku multifunksional me temën e 100 fshatrave në Valias, në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës.

3. Fondi kapital, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, kalohet në “Mjete në Ruajtje”.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama